

V E N D I M
Nr.70, datë 11.2.1999

PËR EVIDENTIMIN E PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë” dhe ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat, që për shkak të papunësisë ose të varfërisë, kërkojnë të përfitojnë nga programet shtetërore të mbështetjes në të ardhura, duhet që në çdo rast, të vërtetojnë nga zyra kompetente e punësimit për gjendjen e tyre si të papunë.

2. Zyra kompetente e punësimit vërteton të qenit i punësuar, i papunë ose punëkërkues i papunë për vetë personin ose organizmin shtetëror, të interesuar për këtë.

3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me librezë personale punësimi të tërë punëmarrësit, klientë të zyrave të punësimit dhe që e pranojnë një gjë të tillë. Në librezën e punësimit shënohen nga punëdhënësi dhe nga zyra kompetente e punësimit marrëdhëniet e punës së mbajtësit të librezës që nga çasti i lëshimit të saj. Zyra kompetente e punësimit shënon në librezë profesionet, specializimet, kurset e kualifikimit dhe të dhëna të tjera, që kanë të bëjnë me formimin dhe aftësitë profesionale. Libreza qëndron e depozituar te punëdhënësi gjatë tërë periudhës që vazhdojnë marrëdhëniet e punës.

Inspektorati Shtetëror i Punës vlerëson si punësim të paligjshëm çdo rast punësimi, për të cilin nuk është depozituar nga punëdhënësi librezë e rregullt e punësimit.

Librezat e punësimit kanë numër serie dhe elementë sigurie. Një personi i jepet vetëm një librezë punësimi. Publikatat për humbjen e origjinalit, dypunësim ose për arsye të tjera të pranueshme shënohen në regjistra dhe janë të ndryshme, në formë nga origjinali.

4. Zyra kompetente e punësimit vlerëson dhe regjistron si të papunë çdo person i cili paraqitet pranë saj, deklaron se nuk është në marrëdhënie pune, nuk është i vetëpunësuar dhe që depoziton pranë saj librezën e punësimit.

5. Zyra kompetente e punësimit vlerëson dhe regjistron si punëkërkues të papunë çdo person të papunë, i cili kërkon punë dhe është i gatshëm të paraqitet sa herë që i kërkohet një gjë e tillë. Një pretendues mund të vlerësohet si punëkërkues i papunë të paktën një muaj kalendarik pas ditës së paraqitjes së tij të parë në zyrën kompetente të punësimit për këtë qëllim.

6. Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis me kartë personale papunësie tërë personat që pranojnë një gjë të tillë. Në kartën e papunësisë bëhet vërtetimi nga zyra kompetente e punësimit e të qenit punëkërkues i papunë i mbajtësit të kartës. Pajisja me kartë papunësie bëhet kundrejt depozitimit në zyrën kompetente të punësimit të librezës së punësimit dhe anasjelltas.

Karta e papunësisë përmban numër serie dhe ka elemente sigurie. Një personi i jepet vetëm një kartë papunësie. Publikatat për humbjen e origjinalit ose për arsye të tjera të pranueshme shënohen në regjistra dhe janë të ndryshme në formë nga origjinali.

7. Personat, të cilët kundërshtojnë vende pune apo pjesëmarrje në programe të tjera shtetërore, të ofruara nga zyra përkatëse e punësimit, hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë.

8. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet në zbatim të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Inspektorati shtetëror i Punës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko